



Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike, në nivel qendror, përgjegjëse për hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit në Shqipëri.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton dhe ndjek kuadrin strategjik kundër korrupsionit, përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të integritetit, politikat dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe të edukimit kundër korrupsionit. Është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve publike që kryejnë abuzime me detyrën. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon mekanizmin e referimit, të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Buletini elektronik është një mjet komunikimi që synon të informojë aktivitetet kryesore, iniciativat dhe zhvillimet në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një përmbledhje mujore të punës së institucionit.

Aktivitetet përgjatë muajit korrik, 2026

Vlerësimi i riskut të korrupsionit në arsimin parauniversitar pilotohet me mbështetjen e Këshillit të Evropës

23.07.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit nis vlerësimin e riskut të korrupsionit në sektorin e arsimit parauniversitar. Pilotimi i procesit të vlerësimit po shoqërohet edhe me një tryezë metodologjike dhe praktike pune për të zbatuar më mirë hapat dhe njohur ekspertët dhe personat teknikë të përfshirë me elementët e procesit. Me mbështetjen e projektit “Veprimi kundër krimit ekonomik në Shqipëri” i zhvilluar dhe financuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, u zhvillua seminari metodologjik “Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorin e arsimit parauniversitar: qasja metodologjike, qëllimi dhe zbatimi”, për anëtarë staf të Drejtorisë së Përgjithshme e Antikorrupsionit, Ministrisë së Arsimit dhe të varësive pranë saj. Seminari morri në shqyrtim dhe tregoi hapat e zbatimit të procesit, identifikimin e përgjegjësive institucionale dhe organizimin praktik të vlerësimit në arsimin parauniversitar. Pjesëmarrësit identifikuan instrumente të duhura për mbledhjen e të dhënave, analizën diagnostikuese të proceseve, identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, dokumentimin e tyre në regjistrin e riskut dhe përcaktimin e masave të mundshme për trajtimin e tyre. Në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit do të drejtojë grupin ndërinstitutional dhe gjetjet do të adresohen në masa konkrete parandaluese, të përshtatura me nevojat dhe specifikat e sektorit të arsimit parauniversitar. Masat do të jenë pjesë e planit të veprimit sektorial me afat kohor 3 vite zbatimi, i cili do të miratohet nga Ministri i Arsimit. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në arsimin parauniversitar është pjesë e mekanizmave të parandalimit në luftën kundër korrupsionit në administratën publike dhe që pritet të minimizojë riskun e keqadministrimit dhe të vendosë bazat e një administrate të mbështetur në integritet dhe ligjshmëri.



Nis hartimi i raportit të monitorimit 6-mujor 1 2026 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

10.07.2026: Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion, i mbledhur dhe organizuar në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 zhvilloi takimin për prezantimin dhe konsultimin e draftit të parë të Raportit të Monitorimit për zbatimin e strategjisë dhe të Planit të Veprimit, periudha gjashtëmujori i parë i vitit 2026. Anëtarë të Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion pranë institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të strategjisë dhe për realizimin e treguesve të saj të performancës, adresuan statusin e zbatimit të strategjisë dhe masat për ndërhyrje në vijim. Hartimi i draft-raportit të monitorimit për periudhën e parë të vitit 2026 është dokumenti bazë që dëshmon për matjen e zbatimit të strategjisë dhe impaktin e saj në performancën me efekte parandalimi në organet e administratës publike. Raporti pritet të përfundojë në fund të muajit gusht 2026 dhe për tu miratuar nga Ekipi Tematik Antikorrupsion. Takimi shërbeu gjithashtu për të promovuar nisjen e hartimit të Planit të ri të Veprimit Antikorrupsion për periudhën 2027-2030. Takimi shërbeu si një forum konsultues për shqyrtimin e informacionit nga institucionet mbi nivelin e formalizimin e ndërhyrjeve në zbatim të objektivëve të strategjisë. Ky raport monitorimi së bashku me të tjerë të viteve 2024 e 2025, do të shërbejnë si një pikënisje për hartimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion për kohëzgjatjen dytë të strategjisë, vitet 2027-2030.

Rregullshmëria e procedurave, ofrimi i shërbimeve publike dhe ligjshmëria në vendimmarrje në fokus të verifikimit administrativ

1-31.07.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijoi me ndjekjen e rasteve të dyshuara të korrupsionit, me verifikime dhe hetime administrative, duke trajtuar ankesat dhe denoncimet e administruara direkt nga struktura e hetimit pranë saj si edhe nga Koordinatorët Kundër Korrupsionit. Verifikimet prëgjatë këtij muaji janë fokusuar në raste që lidhen me mosrespektimin e procedurave administrative, tejkalimin ose mosushttrimin e kompetencave, mungesën e transparencës në vendimmarrje, vonesat në ofrimin e shërbimeve publike dhe problematika të tjera që cenojnë integritetin e administratës publike. Pas analizës së dokumentacionit dhe provave të administruara, si dhe vlerësimit të natyrës së shkeljeve të konstatuara, ndikimit të tyre në funksionimin e institucionit dhe përgjegjësisë individuale të punonjësve të përfshirë, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka konkluduar me dy raporte përfundimtare për DVASHK Tirana Jug dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si dhe ka propozuar 5 masa disiplinore. Në funksion të rolit të saj parandalues, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka dhënë rekomandime për përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e mekanizmave të integritetit. Në raportin përfundimtar të muajit korrik, janë propozuar 15 rekomandime të cilat në 12 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete, dhe në 3 raste adresojnë çështje me natyrë organizative, duke synuar forcimin e mekanizmave të menaxhimit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit institucional.



Raportoni raste të korrupsionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në adresë: koordinatori.ak@dpak.gov.al

TAIEX, një hapësirë bashkëpunimi për promovim të kapaciteteve teknike të autoriteteve shqiptare me kompetenca të luftës kundër korrupsionit

01.07.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në workshop-in e dytë Rajonal TAIEX mbi ndjekjen e raundit 2025-2026 të misioneve të rishikimit nga kolegët (peer review) bazuar në raste konkrete për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, që u zhvillua në Chisinau, Moldavi. Workshop mbledhi përfaqësues të organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të administratës publike nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Ukraina me qëllim prezantimin e gjetjeve kryesore të misioneve të rishikimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe nxitja e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira ndërmjet vendeve të rajonit dhe ekspertëve të Bashkimit Evropian. Gjatë dy ditëve të punimeve u trajtuan çështje që lidhen me përdorimin e inteligjencës në veprimtarinë e organeve të policisë, gjurmimin e aseteve me prejardhje kriminale, parandalimin dhe adresimin e korrupsionit në institucionet ligjzbatuese, mekanizmat parandalues dhe teknikat e hetimit, si dhe menaxhimi i procesit gjyqësor. Një vëmendje e veçantë iu kushtua korrupsionit në sektorët me risk të lartë, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike, ku u prezantuan dhe u diskutuan instrumente parandaluese, si Planet e Integritetit dhe metodologjitë për vlerësimin e riskut të korrupsionit, si mekanizma që kontribuojnë në forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

